



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:022537
Datë: 25.09.2024
Numri i dokumentit: 06204449

C-IV-14-7627
Parashtruesi i kërkesës

S B nga Gjilani, të cilin e përfaqëson avokat M M nga Gjilani.

Kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit – (AKP) (NSH “Banka Themelore e Kosovës” në Likuidim), Rr. “Dritan Hoxha”, nr. 55, Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 25 shtator 2024, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- I. Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN125-0807 datë 3 dhjetor 2014.**
- III. Secila palë i mbulon shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 24 dhjetor 2014, pranë DHPGJS-së, ankuesi parashtror kërkesë, të emërtuar padi, për rishqyrtimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) PRN125-0807 datë 3 dhjetor 2014 (në tekstin e mëtutjeshëm Vendimi), me të cilin kërkesa për dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës, në shumë prej 84,844.90 (tetë katër tetë katër nëntë zero) Euro, ndaj N.SH “Banka Themelore e Kosovës”, është refuzuar për shkak të mos plotësimit të kushteve ligjore të parapara sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP.

Ankuesi konsideron se AKP si administruese e NSH është bartëse e të drejtave dhe detyrimeve të NSH. Ankuesi të drejtën e tij e mbështet në Aktgjykimin e Gjykatës së punës së bashkuar.

Ankuesi pohon se pranë NSH ishte i punësuar nga data 2 shkurt 1978 e gjer në suspendimin e tij nga puna me datë 27 korrik 1990, me arsye e bindjeve politike të asaj periudhe dhe për shkak të aktivitetit të tij si kryetar i sindikatës së pavarur.

Ankuesi tutje pohon se i ka ndjekur të gjitha procedurat ligjore dhe se përfundimisht Gjykata e punës së bashkuar- dega në Gjilan, me Vendimin e saj MP. Nr. 2129/90 datë 27 nëntor 1990 ka anuluar vendimin mbi ndërprerjen – suspendimin nga marrëdhënia e punës datë 27 korrik 1990.

Ankuesi nga të gjitha arsyet i propozon gjykatës që kërkesa e tij të aprovohet, ashtu që të i kompensoj të dëmshpërblimin për periudhën nga muaji qershor 1999 e gjer në muajin qershor 2013, për gjithsejtë 168 muaj, e në shumë totale prej 84,844.04 (tetë katër tetë katër katër zero

Kërkesës për rishikim-kundërshtimit i janë bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL,
- Kopja e Aktvendimit, nr. 745 datë 12 janar 1978, mbi themelimin e marrëdhënies së punës,
- Kopja e Vendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës datë 27 korrik 1990,
- Kopja e Vendimit të Gjykatë themelore të punës së bashkuar – dega në Gjilan, MP. Nr. 2129/90 datë 27 nëntor 1990, sipas të cilit Vendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës datë 27 korrik 1990, është anuluar (në tekstin në vijim VENDIMI i GJTHPB),
- Kopja e Vendimit mbi lejimin e ndërrimit të mbiemrit të ankuesit, nga B në B, dhe
- Kopja e kërkesës kreditore e parashtruar pranë AL.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 5 dhjetor 2023 parashtrorj përgjigjen.

AKP kundërshtoj kërkesën e ankuesit për rishikim duke e konsideruar si të pabazuar. Sipas AKP kërkesa për rishikim-kundërshtimi nuk përmban kushtet ligjore, të parapara sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. Përfundimisht AKP konsideron se kërkesa e ankuesit nuk i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP. Nga të gjitha arsyet AKP i propozoj gjykatës që kërkesën e ankuesit ta hedh si të papranueshme ose refuzon si të pabazuar.

Përgjigjes i është bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL.

Duke veprua sipas urdhrin të gjykatës, përfaqësuesi i ankuesit me 14 shkurt 2024 parashtrorj përgjigjen ndaj përgjigjes së AKP.

Ankuesi mbeti në tërësi si pranë kërkesës për rishikim ashtu që kundërshtoj përgjigjen e AKP dhe përfundimisht tani kërkoj kompensim, sipas të njëjtës bazë, në lartësi prej 78,780.00 (shtatë tetë shtatë zero) Euro duke përfshirë edhe kamatë ligjore në lartësi prej 8%.

Kësaj përgjigje i janë bashkangjitur:

- Kopja e Autorizimit për përfaqësuesin,
- Kopje e VENDIMIT të GJTHPB, dhe
- Kopje të ekspertizës financiare.

Gjykata, me datë 22 shkurt 2024, lëshoj një urdhër për ankuesin me të cilin ju kërkua që të parashtrorj prova, dëshmi, shtesë në mbështetje të pretendimeve të tij.

Ankuesi, sipas urdhrin të cekur si më lartë, parashtrorj kopjen e ekspertizës financiare, dhe tani duke përfshirë edhe kamatë ligjore, kërkon shumën totale prej 119,644.30 (në një nëntë gjashtë katër katër tre zero) Euro.

Arsyetimi Ligjor

Kërkesa për rishikim-ankesa konsiderohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore. Gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 40.1.6.2 i Shtojcës së Ligji për AKP

Bazuar sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast ankuesit, që në parashtrësat e tij me shkrim, ankesën, të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsyetimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e tij. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast ankuesi, të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.

Në rastin konkret ankuesi kërkon kompensim, për periudhën qershor 1999 gjer qershor të vitit 2013.

Provat siç janë AKTENDIMI i GJTHPB, përbën një të drejtë nga marrëdhënia e punës të vitit 1990, kur edhe është anuluar Vendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës së datë 27 korrik 1990 e jo edhe të drejtën dhe detyrimet e NSH ndaj ankuesit për periudhën e kërkuar kohore qershor 1999 e gjer qershor 2013.

Lidhur me pagat e papaguara si dhe kompensimit, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.2 parashihet:

- a. e drejta në kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në .

Tutje sipas nenit 40 paragrafi 1.7, të shtojcës së Ligjit për AKP, parashihet përmbusha e kërkesave siç janë: “kërkesat e pasiguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë”.

Nga dispozitat e lartëcekura, mund të konkludohet se, punëtori/ja gëzon të drejtën në paga respektivisht dëmshpërblim nëse:

- a. Kontrata mbi punën i është ndërprerë para afatit të përfundimit, të saj;
- b. Pushimi nga puna ka ardhur si pasojë i Vendimit të AL, dhe
- c. Ndonjë veprim nga Agjencia, lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes, likuidimit etj.

Në rastin konkret asnjë nga kushtet e parapara ligjore, sipas dispozitave të cekura si më lartë, nuk janë plotësuar.

Ankuesi nuk ka dëshmuar, kushtet kumulative, siç janë:

- a. se ishte i punësuar pranë NSH në periudhën qershor 1999 gjer qershor 2013, dhe
- b. që marrëdhënia e punës i është ndërprerë nga AL, me cilin do veprim të saj.

Vendimet i viti 1990 si ajo nga NSH, mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, e po ashtu VENDIMI i GJTHPB, nuk paraqesin argumente ligjore të parapara sipas nenit nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.2 dhe paragrafi 1.7.

Andaj nga të gjitha arsyet e cekura konsideron se ankuesi nuk e gëzon të drejtën e tij mbi kompensimin mbi ndërprerjen e parakohshme të marrëdhënies së punës siç edhe parashihet sipas nenit 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP, paragrafi 1.6 pika 1.6.2 dhe 1.7 ashtu siç parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS

Nga gjitha arsyet u vendos si në dispozitiv.

Taksa Gjyqësore:

Ankuesi ka paguar taksat gjyqësore.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar